

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm - Divizioni penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarve A.M. dhe B.M. nga fshati Ll., Komuna e P., për shkak se kanë kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 358 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzes së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.6469/15 të dt. 15.02.2016, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur më dt.30.11.2017, në praninë e Prokurorit të Shtetit – Ajshe Ferati dhe të akuzuarve A.M. dhe B.M., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 06.12.2017 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. **A.M.**, nga i ati Sh. dhe nëna M., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin Ll. ku edhe jeton, me nr. personal *numri personal...*, ka të kryer shkollën fillore, me profesion bujk, i gjendjes së mesme ekonomiko, i martuar, baba i 3 fëmijëve, Shqiptar-Kosovar, shtetas i Republikës së Kosovës.
2. **B.M.**, nga i ati Sh. dhe nëna M., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin Ll. ku edhe jeton, me nr. personal *numri personal...*, ka të kryer shkollën fillore, me profesion bujk, i gjendjes së mesme ekonomike jeton, i martuar, Shqiptar-Kosovar, shtetas i Republikës së Kosovës.

J A N Ë F A J T O R Ë

S e p s e :

Me datën 29.09.2015, rreth orës 04:45, me qëllim të vjedhjes, në fshatin P. në vendin e quajtur "...” Komuna e P. pa leje paraprake dhe autorizim në pronë private janë hasur duke prerë dru, të llojit bungu dhe qarri 38 copë, të gjata 12m, me diametër 17-40 cm, me vëllim të përgjithshëm prej 6.05m³, me ç`rast të dëmtuarit S.J. i kanë shkaktuar dëm materjal.

- me këtë kanë kryer veprën penale Vjedhja pylli nga neni 358 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4, 17, 41, 42, 43, 46, 49, 50, 51, 52, 73 dhe nenit 358 par.2 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370, 450, 453, 463 të KPPPK-së, e

G J Y K O N

I. Të akuzuarit **A. (Sh.) M.** dhe **B. (Sh.) M.**, me **dënim me kusht**, ashtu që i shqipton dënim me **burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve**, si dhe me **dënim me gjobë** në shumë prej **200€ (dyqind/euro)**, të cilit dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari **brenda afatit prej 1 (një) viti** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë të re penale.

II. Detyrohen të akuzuarit e lartcekur që në emër të shpenzimeve paushalle të paguajnë **secili veç e veç** shumën prej **25.00€ (njëzetepesë euro)**, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. E dëmtuara Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në P., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.6469/15 të dt. 15.02.2016, kundër të akuzuarve A.M. dhe B.M. nga fshati Ll., Komuna e P., për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 30.11.2017, gjatë të cilës u dëgjuan prokurori i shtetit Ajshe Ferati nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe të akuzuarit A.M. dhe B.M.

Të akuzuarit në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e pranon fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, dhe kerkoj nga gjykata një dënim të butë për shkak se jam i gjendjes së rëndë ekonomike ,puntor fizik , i kam katër (4) fëmijë dhe i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të përseritet.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari dha mendimin duke deklaruar se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ngase është bërë konform dispozitave të KPPRK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar,

andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të të akuzuarit, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penal-juridik është përgjegjës, për çka të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari gjatë shqyrtimit fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, si dhe gjendjen e rëndë ekonomike, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata gjeti se i akuzuari ka qenë i gjykuar edhe më parë për vepër të njëjtë penale, prandaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale.

Mundësia e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim është marr në kuptim të nenit 46 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimit të kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marr në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, pasi që gjykata në shqyrtim gjyqësor nuk pati kërkesë nga pala e dëmtuar për kompensimin e dëmit dhe nuk pati ndonjë ekspertizë nga ekspertë të pavarur lidhur me vlerësimin e dëmit material të shkaktuar nga i akuzuari.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË,
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal
P.nr.87/2015, datë: 19.04.2017**

Sekretarja juridike
Mihrie Krasniqi-Sheholli

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.